



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Kryetarja

Nr. 575 Prot.

Tiranë, më 13.02. 2024

URDHËR

Nr. 8, datë 13.2.2024

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 15.2.2024, ORA 10:00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 5 shkurt – 23 shkurt 2024,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 15.2.2024, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 8.2.2024.
 2. Njoftime.
 3. Interpelancë urgjente me Kryeministrin, zotin Edi Rama, kërkuar nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike.
 4. Projektligj “Për një shtesë në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992, “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar.
 5. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 6. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave, INSTAT”.
 7. Projektvendim “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve me kohë jo të plotë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.
 8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.
- III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.
- IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Lindita NIKOLLA





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 15 shkurt 2024, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrin nr. 8, datë 13.2.2024 të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 8.2.2024.
(Neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)
3. **Interpelancë urgjente me Kryeministrin, zotin Edi Rama, kërkuar nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike.**
(Neni 80 i Kushtetutës, neni 97 i Rregullores së Kuvendit)
4. **Projektligj “Për një shtesë në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore””, të ndryshuar.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për Politikën e Jashtme.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit
5. **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. **Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave, INSTAT”.**

(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, nenit 15, pika 3, të ligjit “Për Statistikat Zyrtare”, dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit.

7. **Projektvendimin “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve me kohë jo të plotë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.**

(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 19, pika 1, shkronja “m”, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar).

8. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.**

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)